- (d) Nëse ekziston një mospërputhje midis fjalëve dhe shifrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë, përveç nëse shuma e shprehur me fjalë lidhet me një gabim aritmetik, rast në të cilin shuma në shifra do të mbizotërojë në bazë të (a) dhe (b) më sipër.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- vlera absolute e të gjitha korrigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- vlera absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por korrigjimi nuk pranohet nga ofertuesi.

2. Kur autoritetet kontraktore vërejnë se oferta është anomalisht e ulët, i kërkojnë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin dhe në përputhje me dispozitat e këtij neni.

- Në rast kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët kur zvogëlohet më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më pak se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, para se të marrë një vendim për kualifikimin e tyre ose jo, në përputhje me nenin 93 të LPP-së.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin / elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit

93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

**O - Oferta**

**MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme**

**N - Numri i ofertave të vlefshme**

**PR (Zm) – Zbritje e mundshme**

**MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N**

**PR = 85 % Mo**

**Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ..... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët**

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

## **D. DHËNIA E KONTRATËS**

**23. Njoftimi i Fituesit** 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

**24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës** 1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) garanci bankare
- b) garanci nga shoqëri sigurimi.

---

## **DH. ANKESAT**

### **25. Procedura e ankesës**

1. Cdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
2. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

## **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

### **26. Anulimi i procedurës**

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
  - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
  - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
  - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
  - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
  - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës .....	
Shtojca 2. Lista e Çmimeve të Sherbimeve .....	
Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës .....	
Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial.....	
Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike .....	
Shtojca 6. Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit .....	
Shtojca 7. Termat e referencës	
Shtojca 8. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve .....	
Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....	
Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit .....	
Shtojca 11 - Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak) .....	
Formulari 12 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)	
Shtojca 13 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)	
Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)	

---

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Shërbimeve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontrates;
  - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
  - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  - 7. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

**Shtojca 2.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Shërbimi	Përshkrimi i shërbimi	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim(3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Shërbimet)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					
<b>Vula</b>					
<b>Datë</b> _____					



---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

---

#### **Shtojca 4.**

*(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkëlqje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

#### **Nënshkrimi**

#### **Vula**

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

<b>Pershkrimi i Sherbimit</b>	<b>Sasia e pritshme (ton)</b>	<b>Kohezgjatja</b>
<b>Transport dhe Evadim i Mbetjeve Urbane</b>	<b>212.60</b>	<b>12 muaj</b>

Largimi i mbetjeve urbane do të realizohet për cdo ditë nga pika e grumbullimit të Spitalit dhe do të kryhet si më poshtë:

Mbetjet urbane do të merren me automjet me autoagregat ose mekanizem vetengarkues/shkarkues të koshave/kazaneve një herë në ditë, për cdo ditë përfshirë ditët e fundjavave dhe ditët e festave zyrtare, si dhe më shpesh sipas kërkesës së Autoriteti Kontraktor.

Operatori duhet të vendosë në dispozicion të autoritetit kontraktor edhe nje automjet të hapur, tip kamioncine, për tërheqjen e mbetjeve urbane që dalin nga përdorimi, sic janë: mobilje, dege pemësh, gjethe pemesh, barishte, etj (kur këto objekte nuk mund te terhiqen me automjet autoagregat). Automjeti i hapur do të paraqitet në SRD vetëm në rastet kur kërkohet nga autoriteti kontraktor.

Operatori duhet të sjellë në vendgrumbullimin e përkohshëm të mbetjeve urbane të spitalit 6 (gjashtë) kazanë në përdorim, për grumbullimin e mbetjeve urbane që do të qëndrojnë në pikën e grumbullimit të mbetjeve deri në fund të shërbimit. Kazanët do të jenë me volum më shumë se 1.1 m3, me kapak. Preferohet që kapaku të ketë hapje të posacme ku të mund të hidhen thasët me mbetje.

Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar jo më pak se 3 (tre) punonjës për të bërë tërheqjen e mbetjeve nga pika grumbullimit dhe pastrimin e zonës përreth pikës së grumbullimit. Personeli i nevojshëm për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave është një shofer dhe dy puntorë për çdo makinë që grumbullon mbetjet. Personeli i OE nuk lejohet te kryeje riciklim në përfitim të tij apo të kompanisë gjatë grumbullimit të mbetjeve. Kushtet e punës për të gjithë stafin duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Stafi i OE duhet të jetë i pajisur me rrobat e përshtatshme të punës, me shenja dalluese që do të bëjnë të mundur identifikimin e tyre gjatë të gjithë kohës, me doreza dhe pajisje të tjera mbrojtëse për sigurimin teknik në punë.

---

OE duhet të bëjë dezinfektimin e zonës përreth kontanierëve, pas zbrazjes së të gjithë kontanierëve, me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori. Frekuenca e dizinfektimit është 2 (dy) herë në javë për periudhë

n Maj - Shtator (ditë të merkurë dhe ditë të shtunë), ndërsa periudhën tjetër të vitit Tetor - Prill 2 (dy) herë në muaj (të hënën e parë dhe të tretë të cdo muaji).

Fatura tatimore për shërbimin e kryer duhet të jetë e shoqëruar nga situacionet e shërbimit të kryer, si dhe procesverbal të firmosur nga grupi i punës që ndjek shërbimin. Në koston e shërbimit do të jetë e përfshirë pagesa e tarifës së landfillit ku do të depozitohen mbetjet urbane, e cila është në ngarkim dhe paguhet nga Operatori Ekonomik gjatë të gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

Cdo muaj do të plotësohet Formulari i Transferimit të Mbetjeve jo të Rrezikshme, i cili është objekt kontrolli nga Inspektoriati i Mjedisit dhe lind si detyrim në zbatim të VKM 229, Datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacioni që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit". Ky formular do të plotësohet nga përfaqësuesit e Spitalit dhe inxhinieri i mjedisit ose eksperti i mjedisit i Operatorit Ekonomik. Formulari i transferimit do të shoqërohet edhe me kopje të flete peshore të landfillit.

Për mbetjet që do të dalin nga inventari ekonomik do të kryhet pesha e kamionit të hapur në peshore të licensuar me shpenzimet e OE përpara dhe pasi të tërhiqen mbetjet.

### **Etapat e punës**

Mbetjet urbane të krijuara në pavionet/shërbimet e SRD, mblidhen nga stafi sanitar dhe dërgohen në vendgrumbullimin e përkohshëm të mbetjeve urbane, që është i përcaktuar nga ana e AK

OE bën tërheqjen e mbetjeve urbane nga koshat/kazanët e mbetjeve urbane të SRD, me automjet me mekanizëm vetëngarkues/vetëshkarkues një herë në ditë, nga ora 15.00 deri në orën 16.00, për cdo ditë, përfshirë ditët e fundjavave dhe ditët e festave zyrtare, si dhe më shpesh sipas kërkesës së Autoriteti Kontraktor.

Stafi i OE duhet të jetë i pajisur me rrobat e përshtatshme të punës, me shenja dalluese që do të bëjnë të mundur identifikimin e tyre gjatë të gjithë kohës, ata duhet të jenë të pajisur me doreza dhe paisje të tjera mbrojtëse për sigurimin teknik në punë.

Mbetjet urbane të krijuara nga ambientet e jashtme të SRD, nga magazinat apo nga asgjësimi i inventarëve dërgohen në vendgrumbullimin e përkohshëm të mbetjeve dhe nëse mbetjet janë voluminoze, do të vendosen jashtë koshave. Në rast se AK e shikon të arsyeshme, porosit OE që të sjellë kamioncinën për tërheqjen e tyre.

Në rastet kur AK kërkon që OE të sjellë kamioncinën, OE bën tërheqjen e mbetjeve urbane voluminoze me punëtorët e tij.

OE pas tërheqjes së mbetjeve urbane duhet të bëjë dezinfektimin e zonës përreth koshave/kazanëve me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori. Frekuenca e dizinfektimit është 2 (dy) herë në javë për periudhën Maj - Shtator (ditë të merkurë dhe ditë të shtunë), ndërsa periudhën tjetër të vitit Tetor - Prill 2 (dy) herë në muaj (të hënën e parë dhe të tretë të cdo muaji). Mbas dizinfektimit punëtorët e OE duhet të lënë koshat/kazanët të rreshtuar në vendin e caktuar.

OE do të dorëzojë situacionin mujor të peshave ditore, i cili do të jetë i shoqëruar me Formularët e Transferimit të Mbetjeve jo të Rrezikshme, në zbatim të VKM 229, Datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacioni që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit". Formularët e Transferimit të Mbetjeve jo të Rrezikshme duhet të jenë të konfirmuar nga Landfilli i licensuar, në mënyrë që të vërtetohet që mbetjet janë dërguar në destinacionin përfundimtar.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

## FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

**Shërbimet që kërkohen që kërkohen:**

**Afatet e ekzekutimit:**

Pershkrimi i Sherbimit	Sasia e pritshme (ton)	Kohezgjatja
Transport dhe Evadim i Mbetjeve Urbane	212.6	12 muaj

### Grafiku i levrimit

Afati i kontratës është 12 muaj. Evadimi i mbetjeve urbane do të bëhet për cdo ditë, një herë në ditë, nga ora 15.00 deri në orën 16.00, përfshirë ditët e fundjavave dhe ditët e festave zyrtare, si dhe më shpesh sipas kërkesës së Autoriteti Kontraktor

- Mbetjet urbane të krijuara në pavionet/shërbimet e SRD, mblidhen nga stafi sanitar dhe dergohen në vendgrumbullimin e përkohshëm të mbetjeve urbane, që është i përcaktuar nga ana e AK
- OE bën tërheqjen e mbetjeve urbane nga koshat/kazanët e mbetjeve urbane të SRD, me automjet me mekanizëm vetëngarkues/vetëshkarkues një herë në ditë, nga ora 15.00 deri në orën 16.00, për cdo ditë, përfshirë ditët e fundjavave dhe ditët e festave zyrtare, si dhe më shpesh sipas kërkesës së Autoriteti Kontraktor.
- Stafi i OE duhet të jetë i pajisur me rrobat e përshtatshme të punës, me shenja dalluese që do të bëjnë të mundur identifikimin e tyre gjatë të gjithë kohës, ata duhet të jenë të pajisur me doreza dhe pajisje të tjera mbrojtëse për sigurimin teknik në punë.
- Mbetjet urbane të krijuara nga ambientet e jashtme të SRD, nga magazinat apo nga asgjësimi i inventarëve dërgohen në vendgrumbullimin e përkohshëm të mbetjeve dhe nëse mbetjet janë voluminoze, do të vendosen jashtë koshave. Në rast se AK e shikon të arsyeshme, porositi OE që të sjellë kamioncinën për tërheqjen e tyre.
- Në rastet kur AK kërkon që OE të sjellë kamioncinën, OE bën tërheqjen e mbetjeve urbane voluminoze me punëtorët e tij.

- 
6. OE pas tërheqjes së mbetjeve urbane duhet të bëjë dezinfektimin e zonës përrëth koshave/kazanëve me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori. Frekuenca e dizinfektimit është 2 (dy) herë në javë për periudhën Maj - Shtator (ditë të merkurë dhe ditë të shtunë), ndërsa periudhën tjetër të vitit Tetor - Prill 2 (dy) here në muaj (të hënën e parë dhe të tretë të cdo muaji). Mbas disinfektimit punëtorët e OE duhet ti lënë koshat/kazanët të rreshtuar në vendin e caktuar.
  7. OE do të dorëzojë situacionin mujor të peshave ditore, i cili do të jetë i shoqëruar me Formularët e Transferimit të Mbetjeve jo të Rrezikshme, në zbatim të VKM 229, Datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacioni që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”. Formularët e Transferimit të Mbetjeve jo të Rrezikshme duhet të jenë të konfirmuar nga Landfilli i licensuar, në mënyrë që të vërtetohet që mbetjet janë dërguar në destinacionin përfundimtar.

---

## Shtojca 7

( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

### TERMAT E REFERENCES

#### 1. Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Nga aktiviteti i përditshëm i Spitalit Rajonal Durrës gjenerohen lloje të ndryshme mbetjesh, ndër të tjera dhe mbetje urbane, të cilat në zbatim të legjislacionit në fuqi duhet të tërhiqen nga ambjentet e SRD nga një operator ekonomik i licensuar sipas objektit të kontratës dhe të dërgohen në landfill të licensuar për grumbullimin e mbetjeve urbane.

Mbetjet urbane të krijuara nga SRD, ne këtë procedurë do i kategorizojmë në mbetje urbane dhe mbetje urbane ekstra. Në mbetjet urbane ekstra do të fusim të gjithë mbetjet urbane të cilat krijohen nga asgjësimi i aktiveve nga inventarët e SRD dhe mbetje të tjera që krijohen nga mirëmbajtja sezonale e ambientit të jashtëm, si për shembull degë pemësh, barishte, etj

#### 2. Detyrat:

Mbetjet urbane të krijuara në pavionet/shërbimet e SRD, mblidhen nga stafi sanitar dhe dërgohen në vendgrumbullimin e përkohshëm të mbetjeve urbane, që është i përcaktuar nga ana e AK

OE bën tërheqjen e mbetjeve urbane nga koshat/kazanët e mbetjeve urbane të SRD, me automjet me mekanizëm vetëngarkues/vetëshkarkues një herë në ditë, nga ora 15.00 deri në orën 16.00, për çdo ditë, përfshirë ditët e fundjavave dhe ditët e festave zyrtare, si dhe më shpesh sipas kërkesës së Autoriteti Kontraktor.

Stafi i OE duhet të jetë i pajisur me rrobat e përshtatshme të punës, me shenja dalluese që do të bëjnë të mundur identifikimin e tyre gjatë të gjithë kohës, ata duhet të jenë të pajisur me doreza dhe paisje të tjera mbrojtëse për sigurimin teknik në punë.

Mbetjet urbane të krijuara nga ambientet e jashtme të SRD, nga magazinat apo nga asgjësimi i inventarëve dërgohen në vendgrumbullimin e përkohshëm të mbetjeve dhe nëse mbetjet janë voluminoze, do të vendosen jashtë koshave. Në rast se AK e shikon të arsyeshme, porositi OE që të sjellë kamioncinën për tërheqjen e tyre.

Në rastet kur AK kërkon që OE të sjellë kamioncinën, OE bën tërheqjen e mbetjeve urbane voluminoze me punëtorët e tij.

OE pas tërheqjes së mbetjeve urbane duhet të bëjë dezinfektimin e zonës përrëth koshave/kazanëve me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori. Frekuenca e dizinfektimit është 2 (dy) herë në javë për periudhën Maj - Shtator (ditë të mërkurë dhe ditë të shtunë), ndërsa periudhën tjetër të vitit Tetor -

---

Prill 2 (dy) here në muaj (të hënën e parë dhe të tretë të cdo muaji). Mbas disinfektimit punëtorët e OE duhet ti lënë koshat/kazanët të rreshtuar në vendin e caktuar.

OE do të dorëzojë situacionin mujor të peshave ditore, i cili do të jetë i shoqëruar me Formularët e Transferimit të Mbetjeve jo të Rrezikshme, në zbatim të VKM 229, Datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacioni që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”. Formularët e Transferimit të Mbetjeve jo të Rrezikshme duhet të jenë të konfirmuar nga Landfilli i licensuar, në mënyrë që të vërtetohet që mbetjet janë dërguar në destinacionin përfundimtar.

### 3. Shpërndarja:

Tërheqjen e mbetjeve urbane nga pika e grumbullimit të mbetjeve urbane në SRD, me automjet me mekanizëm vetëngarkues/vetëshkarkues, do të bëhet një herë në ditë, nga ora 15.00 deri në orën 16.00, për cdo ditë, përfshirë ditët e fundjavave dhe ditët e festave zyrtare, si dhe më shpesh sipas kërkesës së Autoriteti Kontraktor.

### 4. Vendi i kryerjes së shërbimeve: Spitali Rajonal Durrës



---

## Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRZGJEDHJES TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

---

## **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9*

*c. Formulari i Ofertes, sipas shtojcës 1*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, ISO 9001. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
2. Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë OHSAS 18001. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatën ISO 14001 - Sisteme të menaxhimit të mjedisit. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

---

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogel se 40 % e vleres se perlllogaritur te kontrates.

*(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).*

- Kopje te certifikuara / vertetuara te bilanceve per tre vitet (2021-2022-2023) e fundit financiare qe te tregojne raportet ndermjet aktivitet dhe pasivitet. Kerkesa e mesiperme do te konsiderohet e permbushur nese ne bilancet e kerkuara nuk ka raport negativ ndermjet aktivitet dhe pasivitet, Sipas Aktit Normativ Nr.10, date 26.03.2020 per nje ndryshim ne Ligjin Nr.8438, date 28.12.1998 “Per tatimin mbi te ardhurat” i ndryshuar.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

1. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
2. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

- 2.3.1. OE duhet të paraqesë Leje Mjedisore për ushtrimin e aktivitetit në lidhje me objektin që prokurohet.
- 2.3.2. Ne momentin e shpalljes fitues OE duhet të paraqesë kontratë me Landfill të licensuar për depozitim e mbetjeve urbane, të vlefshme.
- 2.3.3. License me Kodi III.2.B për “Grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane”,
- 2.3.4. Dokumentacion që vërteton mundësinë e vënies në dispozicion të SRD për dy automjete, si më poshtë:
  - a. 1 (nje) automjet me mekanizem vetëngarkues/vetëshkarkues të koshave/kazanëve (autoagregat, kompaktor)
  - b. 1 (nje) kamioncine të hapur që nevojiten për mbetjet voluminoze
  - c. Për secilin automjet duhet të sjellë listën e mëposhtme të dokumentave

- 
- a. Dokumenta që vërtetojnë që automjeti është në pronësi, huapërdorje ose me qira, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës: Aktet e pronësisë së mjeteve, ose kontratat origjinale ose të noterizuara të marrjes me qira të mjetit, ose kontratë huaje.
  - b. Leje qarkullimi,
  - c. Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,
  - d. Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve,
  - e. Foto të mjeteve, që do të përdoren gjatë zbatimit të kontratës, për të bërë identifikimin vizual të tyre
- 2.3.5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një punësim prej jo më pak se 4 (katër) punonjësish për periudhën 3 muaj para hapjes së ofertave, duke paraqitur një vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj dhe shlyerjen e të gjithë detyrimeve të sigurimeve shoqërore për këto punonjës për këtë periudhë.
- 2.3.6. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar jo më pak se 3 (tre) punonjës për të kryer shërbimin në SRD. Për punonjësit duhet të
- a. Kontratë të vlefshme pune
  - b. Libreza Shëndetësore
- 2.3.7. Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar 1 (një) Inxhinier Mjedisi ose Ekspert VNM për këtë duhet të paraqesë:
- a. Diplomen e inxhinierit ose Certifikatën e Ekspertit VNM
  - b. Kontratë të vlefshme pune.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shtojca 9.**

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

<b>Identifikimi</b>	<b>Përgjigja</b>
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:			
• <b>Informacione për nënkontraktorin</b>			
<b>Emri i nënkontraktorit</b>	<b>NIPT –i</b>	<b>Përqindja e nënkontraktimit</b>	<b>Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar</b>

<b>të propozuar</b>			

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

<b>Emri (at) e subjekteve</b>	<b>NIPT-i</b>	<b>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</b>	<b>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</b>

## **Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

### **A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

<b>Deklarata</b>
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarimene vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare</p>

nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

